



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 321 prot.

Tiranë, më 27.02.2023

V E N D I M

Nr. 33, datë 27.02.2023

Mbështetur në nenin 32, pika 1, shkronja a), të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr. 159 Regj., datë 13.10.2022, të shtetasës M. D¹, kundër Organizatës “Shërbimi Ligjor Falas”, me pretendimin e diskriminimit për shkak të “shtatzënisë” dhe “lejes së lindjes²”.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi³,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Në parashtrimet e sjella pranë Komisionerit, përfaqësuesja e subjektit ankues para KMD-së, është shprehur lidhur me problematikën e M. D me ish-punëdhënësin, Organizatën “Shërbimi Ligjor Falas”, për të cilën, ndër të tjera, shprehet se⁴:

“Përfaqësoj vajzën time para Komisionerit, për shkak se po kalon një periudhë të vështirë pas largimit të saj nga puna nga ana e Shërbimit Ligjor Falas dhe nuk është në gjendje ta ndjekë personalisht. Në nëntor 2012 vajza filloi punë tek Shërbimi Ligjor Falas. Në 2018 vajza është martuar dhe ka lindur fëmijën e parë në 2019. Puna ka vazhduar normalisht deri në dhjetor të vitit 2021 kur lindi fëmijën e dytë dhe R. B i dërgoi një sms duke i thënë se ka përfunduar projekti.

...Vajza ime ka dy fëmijë 3 (tre) dhe 1 (një) vjeç dhe po kalon periudhë të vështirë për shkak të diskriminimit të znj. B në largimin e saj nga puna”.

¹ Përfaqësuar pranë KMD, nga e ëma, M. K, sipas Deklaratës së ankueses bashkëlidhur ankesës.

² Klasifikuar tek “çdo shkak tjetër” sipas listës jo shteruese të shkaqeve, të përcaktuara në nenin 3 të LMD-së.

³ Në vijim do t’i referohemi me akronimin KMD ose si Komisioneri.

⁴ Mbështetur në transkriptin e bërë nga specialistja e Drejtorisë së Pritjes së Ankesave të shkresës së sjellë me shkrim dore nga M. K.

Në përfundim, subjekti ankues ka kërkuar nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, të konstatojë diskriminim të M. D, nga ana e Shërbimit Ligjor Falas dhe rikthimin e saj në detyrën e mëparshme.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Komisioneri mori në shqyrtim ankesën e sipërcituar, në referencë të kompetencës së parashikuar në nenin 32, pika 1, shkronja a), të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”⁵, të ndryshuar, që i atribuon të drejtën të shqyrtojë ankesat nga personat ose grupet e personave që pretendojnë se janë diskriminuar, sikurse parashikohet në këtë ligj.

Ligji nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë, bazuar në një listë jo shteruese shkaqesh, por në mënyrë të shprehur neni 1, i ligjit parashikon mbrojtjen nga diskriminimi për shkak të “aftësisë së kufizuar”, duke përcaktuar se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.”

Neni 7, i LMD, të ndryshuar, parashikon shprehimisht: “1. Çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash, përbën diskriminim. 2. Eliminimi i të gjitha privilegjeve dhe i diskriminimit të padrejtë, garantohet për cilindo, në bazë të të drejtave vetjake, politike, ekonomike, shoqërore dhe kulturore të siguruara nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë dhe aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi. 3. Autoritetet publike kanë detyrimin për të promovuar barazinë dhe për të parandaluar diskriminimin gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre.”

Në Kreun II, të ligjit të sipërcituar parashikohet mbrojtje e posaçme nga diskriminimi në fushën e punësimit. Ky ligj në nenin 12, të tij parashikon se: “1. Ndalohet diskriminimi i personit në lidhje me të drejtën e tij për punësim. Diskriminimi përfshin çdo dallim, kufizim ose përjashtim që bazohet në shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji.....”

⁵ Në vijim do t'i referohemi me shkurtësën LMD.

Bazuar në nenin 32/1/a të LMD-së, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkeljet që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me këtë shkak.

Përsa më lart, referuar nenit 33, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, ankesa përmban elementët e kërkuar nga ky ligj.

Gjatë shqyrtimit të kësaj ankese, Komisioneri ka marrë në shqyrtim vetëm ato çështje, që bëjnë pjesë në kompetencat e tij, dhe që legjitimohen “ratione temporis” lidhur me afatet⁶ e parashikuara nga LMD për shqyrtimin e tyre.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32 dhe 33, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

1. Nëpërmjet shkresës me nr. 1306/2 prot., datë 17.10.2022, Komisioneri ka njoftuar dhe i ka kërkuar parashtrime Shërbimit Ligjor Falas (në vijim referuar si TLAS ose si Organizata), lidhur me pretendimin e subjektit ankues.

Në vijim, nëpërmjet shkresës me datë 02.11.2022, TLAS, ka njohur Komisionerin me qëndrimin e tij lidhur me pretendimet e subjektit ankues. TLAS, ndër të tjera, ka parashtruar se:

“...TLAS është organizatë joqeveritare, jo fitimprurëse, e regjistruar me vendim të Gjykatës së Rrethit Tiranë, në formën e Qendrës. Organizata funksionon në bazë të hartimit të projekt propozimeve që i përgjigjen misionit të përmendur më sipër dhe jo të gjitha propozimet e draftuara miratohen nga donatorët. Kjo mënyrë e financimit të organizatës dikton edhe mënyrën e organizimit të kontratave të punës, të cilat lidhen me afate që i korrespondojnë afateve të projekteve të miratuara nga partnerët donatorë.

TLAS ka punuar në përgjithësi me numër të konsiderueshëm punonjësish me kohë të plotë, por struktura dhe numri i tyre përcaktohet mbi bazën e projekteve të miratuara në periudhën respektive.

Në dy vitet e fundit 2021 dhe 2022, Qendra ka patur punonjës me kohë të plotë në listë pagesa, përkatësisht 15 punonjës dhe 8 punonjës, pra, ka qenë e pamundur të lidhen kontrata të reja pune për 7 punonjës.

⁶ Neni 33, pika 4, i LMD-së: “Ankesa nuk pranohet nëse: dh) paraqitet më vonë se tre vjet nga ndodhja e diskriminimit ose më vonë se dy vjet nga marrja dijani për sjelljen diskriminuese”.

Kontrata e M. D për vitin 2021 është nënshkruar në dy kopje, njëren nga të cilat e ka punonjësi, ku thuhet shprehimisht që kohëzgjatja e kontratës është 6 muaj, duke filluar nga 1 Janar 2021 deri në datën 30 Qershor 2021.

Ankuesja mori lejen e lindjes me datë 1 Prill 2021, e cila përfundonte në datën 1 Prill 2022. Ndërprerja e marrëdhënies së punës nuk është pasojë e ndonjë vendimi të posaçëm të TLAS, por pasojë e drejtëpërdrejtë e përfundimit të afatit të kontratës së punës. Në këto rrethana nuk mund të flitet për “zgjdhje të kontratës së punës nga ana e punëdhënësit”, por për “përfundim të kontratës të punës për shkak të mbarimit të afatit të saj”. Theksojmë se, kushtet e veçanta të punëmarrësit, qenia me leje lindjeje, nuk ka qenë shkak për ndërprerjen e marrëdhënies së punës. Qenia me leje lindjeje ka penguar ankuesen që të lidhë një kontratë të re pune, pasi ishte në pamundësi të lidhte një kontratë të re pune në ato kushte, por nuk ka qenë shkak për ndërprerjen e saj.

Në përzgjedhjen e stafit të ri të punës TLAS në asnjë rrethanë nuk është drejtuar nga kushte diskriminimi, për çfarëdo shkak. Rimarrja në punë e punonjësve të mëparshëm për afate të reja (mbi projekte të reja të miratuara) ka qenë politike e përhershme e Organizatës pasi është konsideruar si “dobi reciproke” për punëmarrësit dhe vetë Organizatën. Edhe pas përfundimit të marrëdhënieve të punës, Organizata ka mbajtur kontakte të vazhdueshme me ta duke vlerësuar në çdo rast si “prioritare” për punësimet e reja.

Komunikimi për mungesën e financimit është bërë në mënyrë të përsëritur në takimet e stafit dhe ndarja me ankuesen ka qenë mirëkuptuese, madje në datën 27 Mars 2022, ajo ka kërkuar Letër Rekomandimi për të vlerësuar mundësinë e punësimit në vende alternative pune”.

TLAS ka informuar Komisionerin se, gjatë marrëdhënies së punës mes ankueses dhe Organizatës, ndaj ankueses nuk ka patur asnjë masë disiplinore të dhënë ndaj saj, dhe në vlerësimet e punës për të ka patur vlerësime pozitive, si dhe asaj i është sugjeruar në mënyrë të përsëritur të aplikonte për marrjen e licencës së avokatit, pasi ishte shumë e vlefshme për të që të përfaqësonte çështje në gjykatë për individët në nevojë.

- 2. Mbështetur në nenin 33, pika 8, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, për shqyrtimin e mëtejshëm të kësaj ankese, Komisioneri, nëpërmjet shkresës me nr. 1306/4 prot., datë 23.12.2022, njoftoi dhe ftoi palët për pjesëmarrje në seancë dëgjimore.*

Seanca dëgjimore u zhvillua me datë 12.01.2023, pranë Zyrës së Komisionerit. Në seancë u paraqitën përfaqësues të të dyja palëve. Subjekti ankues u përfaqësua nga e ëma e saj, ndërsa TLAS, u përfaqësua nga M. B dhe D. P.

Përfaqësuesja e subjektit ankues u qëndroi të njëjtave parashtime sikurse kishte paraqitur dhe në ankesën e regjistruar pranë KMD-së, duke evidentuar se, vajza e saj, ish-punonjëse pranë TLAS nuk është njoftuar dhe nuk ka qenë në dijeni të faktit që kontrata e punës nuk i është

përsëritur. Ajo ngriti pretendimin se vajza e saj kishte licencën e ushtrimit të profesionit të avokatit në kohën kur ishte e punësuar pranë TLAS-it, dhe ata kanë patur mundësi për ta mbajtur në punë por e kanë larguar kur ajo ishte me leje lindjeje. Ajo ka kërkuar nga TLAS që vajza e saj të rikthehet në punë, me kontratë individuale pune me një afat kohor, aq sa të funksionojë e ekzistojë dhe vetë Organizata.

Nga ana tjetër, përfaqësueset e Organizatës mbajtën të njëjtin qëndrim me parashtrimet e komunikuar Komisionerit shkresërisht me datë 02.11.2022. Ata theksuan se, vendi i punës që mbante ankuesja nuk është shkurtuar, por nuk u mbulua me financim nga projektet e miratuara. Ndërprerja e marrëdhënies së punës me ankuesen është pasojë e drejtëpërdrejtë e përfundimit të afatit të kontratës së punës, dhe në këto rrethana qenia me leje lindje e punëmarrësit M. D nuk ka qenë shkak për ndërprerjen e marrëdhënies së punës me të. Mbase ajo përfundoi lejen e lindjes, në muajin prill 2022, Organizata e kishte të pamundur nga ana financiare lidhjen e një kontrate të re, pasi pozicioni i paraligjorit që mbante ankuesja, gjatë vitit 2022 dhe gjatë vitit 2023 është i pambuluar me fonde të mjaftueshme të akorduara nga projektet e miratuara për të lidhur kontrata të reja.

Lidhur me këtë, përfaqësueset e TLAS theksuan faktin që nuk është lidhur asnjë kontratë e re as gjatë vitit 2022 dhe as për 2023, për punonjës në pozicionin e paraligjorit.

Ata u shprehën se nëse do të krijoheshin mundësi risistemimi në të ardhmen për ankuesen, në varësi të projekteve që do të miratoheshin në të ardhmen, në parim, Organizata ka si prioritet ripunësimi ish-punonjësit e saj, e në këtë këndvështrim e njëjta logjikë do të ndiqet edhe për ankuesen, nëse do të ketë mundësi të reja të krijuara në vijimësi.

3. Në vijim të seancës, *(gjatë të cilës palëve iu komunikua se mund të depozitonin fakte, prova pranë KMD-së, në mbështetje të pretendimeve të tyre, në ditët në vijim)*, përfaqësuesja e subjektit ankues me datë 30.01.2023 depozitoi pranë KMD-së, kopje të:
 - Licencës së Asistent Avokatit në emër të M. D, lëshuar nga Dhoma Kombëtare e Avokatisë të Shqipërisë, me nr. 9851, datë 13.03.2019;
 - Mandat pagesës së datës 02.12.2022, realizuar në Union Bank, për llogari të Dhomës Kombëtare të Avokatisë, në emër të M. D, lidhur me pajisjen e saj me licencën e avokatit.

4. TLAS depozitoi pranë KMD-së dy kopje të vendimeve të Bordit Drejtues të TLAS, lidhur me miratimin e organigramave respektive, si më poshtë citohen:
 - Organigramës së TLAS për vitin 2021;
 - Organigramës së TLAS për vitin 2022;

- Kopje të parashtrimeve datë 12.01.2023, të cilat do të analizohen gjatë trajtimit të pjesës së tretë të këtij Vendimi⁷.

III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.

A. Lidhur me trajtimin e padrejtë, të pabarabartë dhe të pafavorshëm të ankueses nga ana e TLAS.

Bazuar në parashtrimet, kronologjinë e ngjarjeve dhe dokumentacionin e depozituar nga palët në këtë proces, Komisioneri vëren se:

Referuar Librezës së Punës, rezulton se, subjekti ankues ka qenë në marrëdhënie pune me Shërbimin Ligjor Falas, për rreth 7 (shtatë) vite, nga data 01.02.2015 deri me datë 31.03.2022. Tek rubrika “Shkaku i largimit nga puna” në Librezë është cituar: “Përfundim Projekti”.

Pavarësisht faktit se ankuesja ka qenë në marrëdhënie faktike e juridike pune me TLAS për rreth 7 vite, pranë KMD-së janë depozituar vetëm 3 (tri) kontrata pune të formalizuara mes tyre si palë: punëdhënës/TLAS dhe punëmarrës/ankuesja. Kështu citojmë respektivisht:

- Kontratë pune e lidhur me datë 01.01.2019, me kohëzgjatje 12 muaj, në pozicionin “juriste dhe paralegal”;
- Kontratë pune e lidhur me datë 01.01.2020, me kohëzgjatje 12 muaj, në pozicionin “juriste dhe paralegal”;
- Kontratë pune e lidhur me datë 01.01.2021, me kohëzgjatje 6 muaj, në pozicionin “juriste dhe paralegal”.

Referuar të dhënave të Librezës së Punës, evidentohet se, për periudhat kohore:

- Maj 2019 - Maj 2020;
- Prill 2021 - Prill 2022, ankuesja ka qenë me raport leje-lindjeje.

Rregullorja e Brendshme e Qendrës “Shërbimi Ligjor Falas” TLAS, ka parashikuar në mënyrë të hollësishme mënyrën e funksionimit të Organizatës. TLAS ka nisur aktivitetin e tij në janar të vitit 1999, si një nga programet e CAFOD Albania (Catholic Agency For Overseas Development of the Catholic Church of England and Wales of the United Kingdom) dhe është regjistruar në formën e Qendrës/Organizatës me Vendimin nr. 346, datë 18.12.2006, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Neni 3, “Misioni i TLAS” i kësaj Rregulloreje përcakton, ndër të tjera se:

⁷ III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.

“Misioni i TLAS është plotësimi i nevojave ligjore të njerëzve në nevojë, sensibilizimi i shoqërisë shqiptare mbi shtetin e së drejtës dhe të drejtave të njeriut, nxitja e përmirësimeve në sistemin ligjor dhe nëpërmjet tyre të influencojë në zhvillimin e shoqërisë civile dhe të shtetit të së drejtës në Shqipëri.

Organizata do të punojë në bazë të planeve strategjike ë përshtatshme për strukturën organizative dhe metodologjinë e punës për zbatim, shoqëruar me planet operationale në përputhje me misionin e nënvizuar më sipër.

.....

Të gjitha aktivitetet e Organizatës do të kenë në funksion shërbimin falas ndaj grupeve në nevojë...

...përmbushja e misionit dhe objektivave do të bëhet e mundur përmes aplikimit të projekt propozimeve për ngritje fondesh nga donatorë të mundshëm, nga individë ose grupe individësh, nga qeveritë, nga kontribute, donacione, kredi, thirrje publike përmes medias dhe mënyrave të tjera të ligjshme. Fondet e siguruara do të përdoren vetëm për të përmbushur misionin dhe objektivat e Organizatës, të vendosura e miratuara nga Bordi Drejtues i Qendrës”.

Në Rregullore është parashikuar që miratimi i strukturës organizative të Organizatës është kompetencë e Bordit Drejtues të Qendrës, duke parashikuar edhe një dispozitë të veçantë në lidhje me stafin, e cila ka përcaktuar ndër të tjera se:

“Rregullorja e Brendshme zbatohet për të gjithë punonjësit e Qendrës.

.....

Struktura e Qendrës mund të ndryshojë ose të përshtatet në përputhje me projektet dhe programet që do të mbulohen nga ajo.

... pasi financimi të jetë miratuar për këto projekte apo programe, ndryshime të përshtatshme do të jenë bërë në mënyrë që të sigurohet zbatimi i tyre i suksesshëm. Ndryshime të mundshme në strukturë në lidhje me zbatimin e një programi të ri do të konsiderohen dhe miratohen nga momenti që projekti/programi i ri do të miratohet”.

Bazuar në sa më sipër, Komisioneri, vëren se, Organizata e Shërbimit Ligjor Falas, funksionon në bazë të hartimit dhe miratimit të projekt propozimeve që paraqiten kryesisht tek donatorët, në përputhje me nevojat e shpalljet që ata bëjnë. Për rrjedhojë, miratimi vjetor i financimit të projekteve të përzgjedhura, dikton edhe mënyrën e organizimit të saj, miratimit të strukturës organizative, hartimit të kontratave të punës, të cilat lidhen kryesisht me afate që i korrespondojnë aktiviteteve dhe projekteve të miratuara.

Komisioneri vëren se, nga krahasimi i strukturave organizative të TLAS, nga ana e kësaj Organizate, për secilin vit janë lidhur kontrata me kohë të plotë ose të pjesshme, në varësi të projekteve të miratuara.

Nga këqyrja e dy Strukturave Organizative të TLAS, për vitet respektive 2021 dhe 2022, të miratuara me Vendim të Bordit Drejtues të Qendrës “Shërbimi Ligjor Falas”, rezulton se:

- Në organigramën e TLAS për vitin 2021, rezultojnë të jenë të punësuar në total 14 punonjës (duke përfshirë edhe Drejtorin Ekzekutiv), nga të cilët vetëm dy prej tyre me kohë të pjesshme (part time).
- Në organigramën TLAS 2021, për pozicionin që mbante ankuesja si “paraligjor” kishte 3 vende/pozicione në strukturë: ankuesja, V. Gj dhe V. T.
- Në organigramën e TLAS për vitin 2022, rezultojnë të jenë të punësuar në total 9 punonjës (duke përfshirë edhe Drejtorin Ekzekutiv), nga të cilët katër prej tyre me kohë të pjesshme (part time).
- Në organigramën TLAS 2022, pozicioni që mbante ankuesja si “paraligjor” nuk ishte i parashikuar fare në strukturën e Organizatës, pra gjatë vitit 2022 nuk ka asnjë punonjës të emëruar në këtë pozicion.
- Mbledhja për diskutimet dhe miratimin e strukturës organizative të viti 2022, është mbajtur me datë 28.12.2021 (gjatë periudhës së lejes së lindjes së ankueses) dhe Organizata ishte në dijeni të faktit që pozicioni “paralegal” nuk mund të mbulohej bazuar në fondet në dispozicion të saj. Kjo për faktin se, Bordi Drejtues i TLAS, miraton paraprakisht në çdo fund viti organigramën e Organizatës për vitin pasardhës, bazuar në fondet në dispozicion.
- Referuar disa komunikimeve në aplikacionin whatsapp mes ankueses dhe punëdhënësit, me datë 27.03.2022 dhe po ashtu dhe letrës së rekomandimit për të, lëshuar nga Drejtorja Ekzekutive e TLAS, e cila daton me 28.03.2022, evidentohet se ankuesja ka qenë e informuar nga punëdhënësi lidhur me faktin se në përfundim të kontratës së punës me të, TLAS nuk kishte mundësi për ta emëruar në një detyrë tjetër pranë Qendrës duke qenë se pozicioni “paralegal” nuk ishte i parashikuar në strukturën e vitit 2022 për shkak të mosmbulimit me financim nga projektet e miratura për vitin 2022.

Referuar momentit të përfundimit të marrëdhënieve të punës mes palëve: subjektit ankues dhe TLAS, Komisioneri vëren se:

Kontrata e fundit e punës, nënshkruar e dakordësuar mes tyre ishte ajo e datës 01.01.2021, me kohëzgjatje me afat të caktuar 6 (gjashtë) mujor, nga data 01.01.2021-30.06.2021. Ankuesja gjatë marrëdhënieve të punës, ka marrë lejen e lindjes, nga muaji Prill 2021 – Prill 2022.

Bazuar në sa më sipër, rezulton se ankueses, gjatë ushtrimit të së drejtës së saj lidhur me lejen e lindjes, i ka përfunduar kontrata e punës me punëdhënësin.

Kodi i Punës, në nenin 149/1 të tij, ka parashikuar se: *“Kontrata me afat të caktuar përfundon në fund të kohës së parashikuar, pa zgjidhje paraprake”.*

Lidhur me këtë moment, Komisioneri vlerëson se, kontrata e punës e lidhur mes ankueses dhe TLAS, është një kontratë pune me afat të caktuar, nga data 01.01.2021-30.06.2021, dhe bazuar në parashikimin ligjor sa më sipër, kjo kontratë përfundon në fund të kohës së parashikuar, pa zgjidhje paraprake. Pra, kontrata mes saj dhe TLAS ka përfunduar për shkak të mbarimit të afatit kontraktor të parashikuar dhe nënshkruar me vullnetin e lirë të të dyja palëve kontraktore, dhe nuk ka ardhur si rezultat i shtatzënisë apo ushtrimit të lejes së lindjes së saj. Ankuesja që në momentin e nënshkrimit të kontratës, jo vetëm ka qenë në dijeni të afatit të përfundimit të kontratës, por edhe e ka pranuar e nënshkruar me vullnetin e saj të lirë.

Në këtë kuptim, bazuar në sa më sipër, si dhe në referencë të nenit 7, pika 1 të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri gjykon se subjekti ankues nuk i është nënshtruar një trajtimi të padrejtë dhe të pafavorshëm nga ana e Organizatës TLAS.

Në mungesë të një trajtimi të tillë, Komisioneri arrin në konkluzionin që nuk kemi të bëjmë me një sjellje diskriminuese nga ana e Organizatës TLAS, lidhur me përfundimin e kontratës së punës mes saj si punëdhënës dhe ankueses si punëmarrës, ardhur për shkak të shtatzënisë apo lejes së lindjes së saj.

- *Lidhur me pretendimin e ankueses për risistemim në një pozicion pune si “avokat” pranë TLAS, pas përfundimit të lejes së lindjes.*

Neni 149/1⁸ i Kodit të Punës, ka parashikuar për punëdhënësin se: “Punëdhënësi informon punëmarrësin e punësuar me kontratë me afat të caktuar për vendet e lira të punës dhe i siguron mundësi të barabarta me punëmarrësit e tjerë për t’u punësuar në një punë me afat të pacaktuar”.

Nga këqyrja e dy organigramave të TLAS për vitet 2021 dhe 2022, rezulton se:

- Në organigramën e TLAS të vitit 2021, për pozicionin “avokat” kishte 3 vende/pozicione në strukturë: A. M⁹, M. M dhe R. B, dhe 3 vende/pozicione pune për “paraligjor”: ankuesja, V. Gj dhe V. T.
- Në organigramën e TLAS të vitit 2022, për pozicionin “avokat” kishte sërish 3 vende/pozicione në strukturë, një avokat të parë, njëloj si në strukturën e vitit 2021 por me ndryshimin që në këtë vit për dy avokatët e tjerë ishte parashikuar që, njëri prej tyre mbulonte edhe detyrën e arkëtarit, ndërsa avokati i tretë ishte i punësuar me kohë të pjesshme (part time) dhe vetëm për çështje penale.

⁸ Informimi për vendet e lira të punës dhe mundësinë e punësimit.

⁹ Avokat i parë.

Lidhur me sa më lart, Komisioneri konstaton se, në momentin e përfundimit të lejes së lindjes, në prill 2022, në strukturën organike të TLAS, për vitin 2022 nuk ka patur asnjë pozicion pune si “paraligjor”, pozicion pune që mbante ankuesja gjatë marrëdhënies së saj të punës me Organizatën. Nga dokumentacioni i depozituar evidentohet se nga nga ana e TLAS, nuk është lidhur asnjë kontratë e re gjatë vitit 2022 (madje as gjatë 2023) në pozicionin e paraligjorit.

Komisioneri gjen të arsyeshëm e të justifikuar shpjegimin e dhënë nga TLAS lidhur me rënien e financimit të shërbimit të ndihmës ligjore parësore nga donatorët për OJF-të, për shkak se, me ngritjen e fillimit e funksionimit të drejtorive e qendrave përkatëse të ndihmës juridike parësore, në zbatim të ligjit nr. 111/2017 “*Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti*”, hyrë në fuqi me 1 Qershor 2018, (ku gjatë 2021 e më pas, u ngritën 12 të tilla në të gjithë Shqipërinë) financuar nga shteti, donatorët nuk ishin më aq të ndjeshëm e të fokusuar për të financuar këtë lloj shërbimi, i cili deri para dy viteve, më së shumti mbulohej nga organizatat jo qeveritare, siç ishte dhe TLAS. Ky shërbim falas (shërbimi parësor dhe dytësor) që më përpara mbulohej kryesisht apo vetëm nga OJF, aktualisht nga viti 2021 e në vijim mbulohet kryesisht nga strukturat shtetërore përkatëse të Drejtorive të Ndihmës Juridike Falas të garantuar nga shteti (Drejtorisë qendrore dhe atyre rajonale).

Në kuadër të shqyrtimit të pretendimit të ankueses përse i takon mundësisë që ajo të vijonte punën pas lejes së lindjes në pozicionin si “avokat”, duke u krahasuar me punonjësit e tjerë që ishin emëruar në pozicionin “avokat”; Komisioneri gjykon se ankuesja nuk është në kushte të njëjta apo të krahasueshme me punonjësit që ishin të emëruar “avokat”, për arsyet e mëposhtme:

- Ankuesja nuk mund të emërohej/punësohej në këtë pozicion pasi nuk kishte licencën e avokatit.
- Bazuar në dokumentacionin e depozituar nga përfaqësuesja e ankueses, si dhe nga pohimet e palëve gjatë procesit administrativ tek KMD, ankuesja në momentin e përfundimit të lejes së lindjes, deri më datë 31.03.2022 nuk zotëronte licencë avokati, por vetëm atë të asistent avokatit.
- Mandat pagesa në Union Bank, për llogari të Dhomës Kombëtare të Avokatisë, në emër të ankueses, lidhur me pajisjen e saj me licencën e avokatit, daton me 02.12.2022.

Komisioneri gjykon se, në kuadër të nevojave specifike, që mund të paraqiten para Organizatës, rast pas rasti, një avokat mund të realizojë detyrën e punën e një paraligjori, ndërsa e kundërta jo, pasi një jurist/paraligjor nuk mund të përfaqësojë individin në gjykatë nëse nuk është i pajisur me licencën e avokatit. Në këtë kuadër, ankuesja përse kohë nuk ishte e pajisur me licencën e avokatit nuk mund të përfaqësojë të interesuarit në gjykatë. Për rrjedhojë ajo nuk mund të emërohej në pozicionin e avokatit, në strukturën e vitit 2022, në përfundim të lejes së lindjes.

Në analizë të sa më sipër, si dhe në referencë të nenit 7, pika 1 të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri gjykon se subjekti ankues nuk i është nënshtruar një trajtimi të padrejtë dhe të pafavorshëm nga ana e Organizatës TLAS, lidhur me risistemim në një pozicion pune si “avokat” pranë TLAS, pas përfundimit të lejes së lindjes.

Në mungesë të një trajtimi të tillë, Komisioneri arrin në konkluzionin që nuk kemi të bëjmë me një sjellje diskriminuuese nga ana e Organizatës TLAS, lidhur me këtë moment, ardhur për shkak të shtatzënisë apo lejes së lindjes së saj.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 32 dhe 33, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar,

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Konstatimin e mosdiskriminimit të subjektit ankues, M. D, në fushën e punësimit, nga ana e Organizatës “Shërbimi Ligjor Falas”, për shkak të shtatzënisë apo lejes së lindjes së saj.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

KOMISIONERI

Robert GAJDA

Fusha: Punësim

Shkaku: Shtatzëni, leje lindjeje
Lloji i vendimit: Mosdiskriminim